



BASHKIA PATOS
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**KODI ETIKËS PËR
AUDITUESIT E
BRENDSHËM**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA PATOS
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1594 / Fot

Patos, më 10.07 / 2023



MIRATOI
KRYETARI
Fation Dur

KODI I ETIKËS PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË BASHKINË PATOS

Kodi i Etikës përmban parimet që rregullojnë sjelljen e audituesve të brendshëm në Bashkinë Patos në kryerjen e shërbimit të Auditimit të Brendshëm. Ky dokument përshkruan kërkesat minimale për sjelljen dhe pritshmërinë e sjelljes së audituesve të brendshëm.

Qëllimi i Kodit të Etikës është të promovojë kulturë etike në profesionin e audituesit të brendshëm të Bashkisë Patos.

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmerinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Kodi i Etikës shtrihet përtej përkufizimit të auditimit të brendshëm duke përfshirë dy komponentë:

- a) Parimet; që janë në përputhje me profesionin dhe praktikën e auditimit të brendshëm;
- b) Rregullat e sjelljes; që përshkruajnë normat, sjelljen që pritët nga audituesit e brendshëm.

Këto rregulla janë një ndihmë për interpretimin e parimeve në aplikimet praktike dhe kanë për qëllim të udhëzojnë rregullat e sjelljes etike të audituesve të brendshëm si profesionistë.

Ky Kod Etike zbatohet si për subjektet ashtu edhe për individët që kryejnë shërbime të auditimit të brendshëm.

Për të gjithë audituesit e Brendshëm, shkeljet e Kodit të Etikës do të vlerësohen dhe administrohen sipas akteve ligjore në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1598 Prot
1

Patos, më 10 07 2022



MIRATO
KRYETARI
Fation Durr

KODI I ETIKËS PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË BASHKINË PATOS

Kodi i Etikës përmban parimet që rregullojnë sjelljen e audituesve të brendshëm në Bashkinë Patos dhe kryerjen e shërbimit të Auditimit të Brendshëm. Ky dokument përshkruan kërkesat minimale për sjelljen dhe pritshmërinë e sjelljes së audituesve të brendshëm.

Dëllimi i Kodit të Etikës është të promovojë kulturë etike në profesionin e audituesit të brendshëm të Bashkisë Patos.

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillime për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmerinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Kodi i Etikës shtrihet përtej përkufizimit të auditimit të brendshëm duke përfshirë komponentë:

- Parimet; që janë në përputhje me profesionin dhe praktikën e auditimit të brendshëm;
- Rregullat e sjelljes; që përshkruajnë normat, sjelljen që pritet nga audituesit të brendshëm.

Rregulla janë një ndihmë për interpretimin e parimeve në aplikimet praktike dhe kanë për qëllim të udhëzojnë rregullat e sjelljes etike të audituesve të brendshëm si profesionistë.

Kodi i Etikës zbatohet si për subjektet ashtu edhe për individët që kryejnë shërbime të auditimit të brendshëm.

Për të gjithë audituesit e Brendshëm, shkeljet e Kodit të Etikës do të vlerësohen dhe administrohen sipas rregullave ligjore në fuqi.

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

PARIMET DHE RREGULLAT E SJELLJES

Dispozitat e këtij Kodi të Etikës mbulojnë parimet bazë të disiplinave të ndryshme në praktikën profesionale të auditimit të brendshëm. Audituesit e brendshëm duhet të kuptojnë se kërkohet një gjykim individual në zbatimin e këtyre parimeve. Ata kanë një përgjegjësi që të sillen në mënyrë që besimi dhe integriteti i tyre nuk duhet të vihen në pikëpyetje.

Referuar kufirit të aftësive të tyre teknike, ata duhet të promovojnë një nivel sa më të lartë të mundshëm profesional të standardeve të auditimit me qëllim final mbrojtjen e interesit publik.

1. Parimet

1.1 Integriteti profesional

Integriteti i audituesve të brendshëm vendos besimin mbi bazën e të cilit sigurohet mbështetja për gjykimin e tij.

1.2 Objektiviteti

Audituesit e brendshëm duhet të shfaqin objektivitetin në nivelin më të lartë profesional në mbledhjen, vlerësimin dhe komunikimin e të dhënave mbi aktivitetin ose procesin që është nën auditim.

Audituesit e brendshëm bëjnë vlerësime të balancuara të të gjitha rrethanave përkatëse dhe nuk duhet të ndikohen nga interesat e tyre apo nga të tjerët në formulimin e gjykimeve të tyre, apo dhënien e rekomandimeve etj.

1.3 Konfidencialiteti

Audituesit e brendshëm duhet të respektojnë vlerat dhe pronësinë e informatave që marrin, pa dhënë informacion shpjegues pa autoritetin e duhur nëse nuk ka një detyrim ligjor ose profesional për ta bërë këtë.

1.4 Kompetenca

Audituesit e brendshëm aplikojnë dijet dhe njohuritë, si dhe eksperiencën e nevojshme për një performancë të lartë të auditimit të brendshëm.

2. Rregullat e sjelljes

2.1 Integriteti personal

Audituesit e brendshëm:

Duhet të kryejnë punën e tyre me ndershmëri, kujdes dhe përgjegjshmëri.

- 2 Duhet të zbatojnë ligjin dhe të bëjnë zbulimet e pritshme bazuar në ligj dhe në gjykimin profesional.
- 3 Nuk duhet të jenë palë me vetëdije në veprimtari të paligjshme ose të angazhohen në veprimtari që diskreditojnë profesionin e auditimit të brendshëm ose organizatën ku ata punojnë në këtë rast Bashkia Prrenjas.
- 4 Duhet të respektojnë dhe kontribuojnë në objektivat legjitime dhe etike të Bashkisë Patos

2.2 Objektiviteti

Audituesit e brendshëm

1. Nuk duhet të marrin pjesë në asnjë aktivitet ose marrëdhënie që mund të dëmtojë ose parashikon të dëmtojë vlerësimin e paanshëm. Kjo pjesëmarrje përfshin ato veprimtari që mund të jenë në konflikt me interesin e Bashkisë Prrenjas.
2. Nuk duhet të pranojë asgjë që mund të dëmtojë ose parashikon të dëmtojë gjykimin e tij profesional.
3. Duhet të zbulojë të gjitha faktet materiale të njohura prej tij, të cilat nëse nuk zbulohen shkaktojnë shtrembërim të raportimit të aktiviteteve nën auditim.

2.3 Konfidencialiteti

Audituesit e brendshëm:

1. Duhet të jenë të kujdesshme në përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit të marrë gjatë veprimtarisë audituese.
2. Nuk duhet të përdorin informacion për ndonjë përfitim personal ose në çfarëdo mënyre që të jetë në kundërshtim me ligjin ose e dëmshme për objektivat legjitime dhe etike të njësisë që auditohet.

4 Kompetenca

Audituesit e brendshëm:

1. Duhet të angazhohen vetëm në ato shërbime për të cilat ata kanë njohuritë e nevojshme aftësitë, dhe përvojën e duhur.
2. Duhet të kryejnë shërbime të auditimit në përputhje me Standardet e Auditimit, ligjet dhe rregulloret.

fuqi, Kartën e AB të Bashkisë Patos etj.

Duhet të përmirësojnë vazhdimisht aftësitë e tyre, si dhe efektivitetin dhe cilësinë e shërbimit të tyre si auditues të brendshëm.

Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm

Ernesta Hamiti



Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos